

AGRI.BI.

ENTI BILATERAL PËR AGRIKULTURËN VERONEZE

Siguria mbi të gjitha

BROSHURË PËR MBIKQYRJEN SHËNDETËSORE DHE INFORMIMIN/EDUKIMIN E PUNËTORIT

AI SENSI DEL D.I. 27/03/2013

SIGURIA NË AGRIKULTURË

Tekst i vetëm Dekret legjislativ 81/08 e s.m.i.

Organizimi i ndërmarrjes

Punëdhënësi është personi që punëson punëtorin.

Duhet të sigurojë:

- vlerësimin e rreziqeve në ndërmarrje duke përpunuar Dokumentin e Vlerësimit të Rreziqeve (D.V.R.)
- furnizimin e mekanizmit të mbrojtjes personale (M.M.I)
- edukimin, informimin dhe stërvitjen e punëtorëve
- mbikqyrjen me qëllim që punëtorët të respektojnë mënyrat e veprimit të parashikuara tek D.V.R.

Drejtuasi zbaton direktivat e punëdhënësit, organizon aktivitetet dhe mbikëqyr mbi to.

Përgjegjësi mbikëqyr aktivitetet e punës dhe garanton zbatimin e direktivave të dhëna nga punëdhënësi dhe nga drejtuesi, duke kontrolluar zbatimin korrekt nga ana e punëtorëve.

Organizimi për sigurinë (diagrama e organizimit në ndërmarrjen tuaj)

RSPP Përgjegjësi i Shërbimit të Parandalimit dhe Mbrojtjes brenda ndërmarrjes. Zakonisht është punëdhënësi por mund të jetë edhe një konsulent jashtë ndërmarrjes

RLS/RLST Përfaqësuesi i punëtorëve për sigurinë. Përfaqëson punëtorët për aspektet e sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës. I propozon Punëdhënësit aktivitete për parandalimin.

Punonjesi kundër zjarrit ndërhyr në raste zjarri dhe bën që të respektohen procedurat e emergjencës.

Punonjësi i ndihmës së shpejtë jep ndihmën e parë në rast sëmundjeje.

Mjeku kompetent kontrollon gjëndjen shëndetësore të punëtorëve (nëse punëtori është i ekspozuar ndaj rreziqeve për shëndetin)

Punëtori

Ka të drejtë:

- Të jetë i informuar mbi rreziqet në ndërmarrje (shiko skedën e mëposhtme).
- Të jetë i formuar mbi rreziqet e punës që i ka caktuar punëdhënësi.
- Të jetë i pajisur me mjetet për mbrojtjen individuale (D.P.I) të parashikuara për punën që kryen.
- Të njohë procedurat kundër zjarrit dhe ato të ndihmës së shpejtë të parashikuara nga punëdhënësi
- Të njohë organizmin e ndërmarrjes në lidhje me sigurinë.

Ka për detyrë:

- Të vishet me pajisjet e mbrojtjes individuale të parashikuara dhe të dhëna nga punëdhënësi
- Të vërë në praktikë udhëzimet operative të parashikuara nga punëdhënësi.
- Të njoftojë për çdo problem që ka të bëjë me sigurinë në vëndin e punës.
- Të mos ketë sjellje rreziku që i shkaktojnë dëm vetes edhe të tjerëve

RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Mikroklima dhe Ekspozimi diellor

Gjatë veprimeve të krasitjes dhe mbledhjes punëtori mund të përballohet me situata klimatike jo të favorshme, duke punuar në vënde të ngrohta/të ftohta, me shumë lagështi apo ventilim. Ka mundësi që punëtori të ekspozohet në dritën e diellit në momentet qendrore të ditës, kur dielli është më i fortë.

Pjesët e trupit që preken

Gjithë trupi (edhe organet e brendshme),
Sytë
Koka
Qafa
Shpatullat

Çfarë mund të shkaktojë?

- o Dehidratim
- o Goditje nga nxehtësia
- o Ngrirje
- o Stres në organet e brendshme
- o Dëmtim në lëkurë (acarim, djegje nga dielli)
- o Dëmtim syve

Çfarë duhet bërë?



- ✓ Duhet pirë vazhdimisht ujë gjatë ditës, hidratim.
- ✓ Në muajt e nxehtë pushimi duhet bërë në hije dhe në muajt e ftohtë në diell, duke respektuar pauzat e caktuara nga punëdhënësi.
- ✓ Duhet mbrojtur koka, qafa dhe shpatullat, me kapele me strehë të gjerë, e bërë me pëlhurë që i reziston rrezeve UV.
- ✓ Duhet mbrojtur sytë, kur është e nevojshme.
- ✓ Duhet të vishen rroba të përshtatshme (shiko seksionin veshje të përshtatshme)



RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Trajtimi Manual i Ngarkesave

Punëtorët, në funksion të punës së tyre duhet të mbledhin dhe të spostojnë shporta/kova/kuti/ arka ose lëndë.

Pjesët e trupit që preken

Këmbët
Kurri
Krahët
Duart

Çfarë mund të shkaktojë?

- o Dhimbjen e gjymtyrëve dhe të duarve
- o Dëmtimin e muskujve
- o Probleme në shtyllën kurrizore
- o Shtypjen e këmbëve

Çfarë duhet bërë?



- ✓ Përdor mjetet në dispozicion (p.sh karroca)
- ✓ Redukto në minimum peshën e materialit në lëvizje
- ✓ Redukto në minimum numrin e kontejnerëve që transportohen njëkohësisht
- ✓ Gjatë transportit, ngarkesa duhet të jete e shpërndarë dhe e balancuar mirë
- ✓ Përkul këmbët e jo kurrizin
- ✓ Shmang përdredhjet e trupit gjatë spostimit të ngarkesës
- ✓ Mbaje ngarkesën pranë trupit
- ✓ Para se të lëvizësh materialin, kontrollo që mos të ketë pengesa gjatë rrugës



RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Lvizjet e përsëritura dhe mbipeshat në gjymtyrët e sipërm

Në aktivitetin e krasitjes dhe të mbledhjes, punëtori bën lëvizje të përsëritura të gjymtyrëve të sipërm duke përdorur gërrshërë ose thjesht duke mbledhur me duar produktin.

Pjesët e trupit që preken

Dora
Bërryli
Kyci i dorës
Krahët
Shpatullat
Kurri

Çfarë mund të shkaktojë?

- o Tendinite
- o Shqetësime të shtyllës kurrizore
- o Shqetësime në muskujt e gjymtyrëve të sipërm


Çfarë duhet bërë?

- ✓ Kontrolli i gjendjes së mirëmbajtjes/përdorimit të pajisjeve manuale
- ✓ Përdorimi i mjeteve me doreza të përshtatshme
- ✓ Përdorimi i gërrshërëve manuale me sustë kthimi
- ✓ Bërja e pauzave sipas indikacioneve të punëdhënësit



RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Qëndrimi jo korrekt i trupit	Çfarë mund të shkaktojë?	Çfarë duhet bërë?
Gjatë punës së mbledhjes dhe krasitjes, punëtori i bujqësisë mund të marri pozicione jo korrekte të trupit për periudha të zgjatura (krahët sipër linjës së shpatullave, qëndrimi përkulur ose në këmbë për një kohë të gjatë, përkulja jo korrekte e gjunjëve)	- o Shqetësime të shtyllës kurrizore - o Shqetësime muskulare të skeletit	✓ Mbajtja e trupit në mënyrë të përshtatshme që të mos shkaktojë dhimbje ✓ Nuk duhet ndenjur për shumë kohë në të njëjtin pozicion ✓ Të respektohen ne pune paizat e caktuara nga punëdhënësi
Pjesët e trupit që preken		
Gjunjët Kurrizi Dora Krahët		



RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Rreziku Mekanik/Djegjet

Mbledhësit dhe krasitësit gjatë punës mund të hyjnë në kontakt me vegjetacionin. Mund të ndodhë projektimi i materialeve gjatë përdorimit të pajisjeve manuale. Punëtorët e bujqësisë mund të rrëshkasin në terren ose të përplasen aksidentalisht me materiale, pajisje dhe impiante të pranishëm në vendin e punës. Qarkullimi i mjeteve të ndërmarrjes paraqet rrezikun e shtypjes së këmbëve

Pjesët e trupit që preken

Koka
Sytë
Trupi
Krahët, duart
Këmbët

Çfarë mund të shkaktojë?

- o Prerje
- o Deformime
- o Shembje
- o Frakturë
- o Gërvishtje
- o Shtypje
- o Djegje nga kontakti me pjesë të nxehta të impianteve dhe objekteve

Çfarë duhet bërë?

- ✓ Përdor dorashka (shiko seksionin DPI)
- ✓ Përdor syze (shiko seksionin DPI)
- ✓ Këpucë pune (shiko seksionin DPI)
- ✓ Mba distanzë nga kolegët gjatë veprimeve në punë
- ✓ Mba distanzë nga mjetet
- ✓ Mos përdor makineri apo mjete per të cilat është e parashikuar një përgatitje e veçantë
- ✓ Përdor këllëfin për gërshërët e mos i mbaj në xhep





RREZIQE NË AGRIKULTURË NGA KRASITJA DHE MBLEDHJA

Rreziku Biologjik

Gjatë punimeve ka mundësi të hyhet në kontakt (edhe padashur) me:

- Insekte, kafshë dhe sekrecionet e tyre
- Myk
- Lëndë të ndotura
- Spore të tetanozit

Çfarë mund të shkaktojë?

- o Sëmundje infektive
- o Alergji
- o Sëmundje në rrugët e frymëmarrjes
- o Tetanoz


Çfarë duhet bërë?

- ✓ Vaksina e tetanozit
- ✓ Duhet mbajtur një higjienë e përshtatshme personale
- ✓ Duhet veshur rrobat e duhura (shiko seksionin DPI)
- ✓ Duhet veshur këpucë të mbyllyra ose cizme (shiko seksionin DPI)
- ✓ Duhet veshur dorashka (shiko seksionin DPI)



Pjesët e trupit që preken

Sytë
Goja
Hunda
Duart
Kembet
Lekura
Organet e brëndshme




SHKALLËT

Gjatë punës së mbledhjes, vjeljes, krasitjes, etj., punëtori e vë shkallën gjithmonë përballë në lidhje me pemën, për të shmangur humbjen e ekuilibrit dhe rënien. Para se të përdorë shkallën punëtori duhet të kontrollojë:

- Prezencën e shënjes UNI- EN 131,
- Gjëndjen e konservimit të mjetit,
- Që mbajtëset dhe kunjat të jenë kundër rreshqitjes,
- Që të jetë gjithmonë e mbështetur apo e siguruar në bazë nga një bashkëpunëtor.
- Që të arrijë të paktën një metër mbi nivelin e hyrjes.

Për të shmangur situata rreziku, evitoni të ngjisni tre shkallët e fundit.



MJETET E PËRDORURA NGA MBLEDHESI/KRASITËSI


GËRSHËRËT MANUALE, ELEKTRIKE DHE PNEUMATIKE

Rreziket në përdorimin e gërshërëve manuale, elektrike dhe pneumatike janë:

- prerja,
- pengesat/rrëzimet për shkak të kabllave të energjisë,
- lëvizjet e përsëritshme të gjymtyrëve të sipërm,
- pozicioni i gabuar i trupit

Gjatë punës së krasitjes dhe mbledhjes së frutave, punëtori duhet të:

- Kontrollon gjendjen e mirëmbajtjes së gërshërëve
- Kontrollon prezencën e mbrojtjes së komandës njeri prezent (kundër ndezjes aksidentale)
- Përdorë syze mbrojtëse dhe dorashka (shiko seksionin DPI)
- Përdorë një mbështjellës ose ti vendosë kabllot në mënyrë që të mos krijojnë pengesë,
- Pozicionohet larg nga punëtorët e tjerë,
- Vendosë mjetin në një vënd të përshtatshëm ose këllëf, sidoqoftë në një vënd të sigurt dhe jo në xhep;
- të marrë parasysh disa pauza siç i ka caktuar punëdhënësi, për të shpłodhur kycet, duart dhe krahët.



MJETET E PËRDORURA NGA MBLEDHESI/KRASITËSI

KAMIONCINI QË MBLEDH FRUTAT

Gjatë punës së mbledhjes duhet patur parasysh të mos ngacmohen mbrojtëset, të ndiqen udhëzimet e shoferit, nuk duhet zgjatur trupi jashtë automjetit dhe duhet qëndruar në siguri kur është në lëvizje duke përdorur dorezat e posacme. Duhet zbritur vetëm kur mjeti ka ndaluar dhe në fund duhen mbajtur distanzat me punëtorët e tjerë.



SHKUNDËSI ELEKTRIK

Gjatë punës së mbledhjes së ullinjve, punëtori përdor një shkundës elektrik. Përdorimi i këtij mjeti sjell një ekspozim ndaj vibracioneve dhe qëndrime jo të përshtatshme. Kjo gjë mund të shkaktojë dëme nga mbipesha në gjymtyrët e sipërm dhe dëme në aparatën muskular të skeletit, si dhimbje kurrizi, dhimbje të nervit shiatic dhe dhimbje të shpatullave e të bërrylit. Për të evituar që kjo të ndodhi, është e nevojshme të bëhen disa pauza të caktuara nga punëdhënësi dhe të alternohet personeli që përdor shkundësin elektrik me personelin që merret me rrjetën.



PAJISJET E MBROJTJES PERSONALE

KËPUCËT E SIGURISË




Gjatë punës së mbledhjes e krasitjes punëtorët veshin sipas udhëzimeve të punëdhënësit, këpucë ose çizme me gomë, kundër rëshqitjes, në bazë të gjëndjes klimatike dhe të tokës. Kundër rrezikut të prerjes dhe shtypjes aksidentalisht, në rastin e kalimit të mjeteve apo lëvizjes së peshave, këpucët duhet të kenë majën e përforcuar. Për rreziqet e lidhura me punët e mbledhjes përdoren këpucë të thjeshta, të shënuara CE, të klasifikuara të paktën SB.

SYZET MBROJTËSE



Punëtorët që merren me mbledhjen dhe krasitjen mund të veshin, sipas udhëzimeve të punëdhënësit, syze që mbrojnë nga agentët fizikë (dielli) dhe nga agentët mekanikë (projektimi i materialeve, kontakti me vegjetacionin). Syzet mbrojtëse duhet të jenë të shënuara si tek lentja ashtu edhe tek skeleti me shenjë CE.

Shembull i shënimit të lentes:



Në rastin e punimeve me dukshmëri të ulët, përdoren syze që ndryshojnë ngjyrën, për shembull me lente të verdha.

DORASHKA



Dorashkat gjatë punimeve në agrikulturë janë thelbësore për mbrojtjen nga prerjet, shtypjet, konsumimi dhe ndotja. Për çdo lloj punimi përdoren dorashka të ndryshme; është detyrë e punëdhënësit ti tregojë punëtorit llojin e dorashkës që duhet të përdoret mundësisht.

Klasifikimi i dorashkave

Mbrojtja nga rreziqet mekanike – simboli



- 4 shifra
- konsumimi nga 0 në 4
 - prerje nga brisku nga 0 në 5
 - prishja nga 0 në 4
 - shpimi nga 0 në 4

Për rreziqet në lidhje me mbledhjen përdorni dorashka 4141.

Për rreziqet në lidhje me krasitjen përdorni dorashka 4341.

Në rast punimesh në muajt e dimrit përdorni dorashka që mbrojnë nga i ftohti - simboli



- 3 shifra
- I ftohtë konvektiv nga 0 në 4
 - I ftohtë nga kontakti nga 0 në 5
 - Padepërtueshmëri nga uji nga 0 në 1
- Për rreziqet në lidhje me krasitjen dimërore përdorni dorashka x2x

Për punimet në kontakt me lëndë biologjike përdorni dorashka me simbolin



VESHJA E PËRSHTATSHME



Veshja e rrobave njëra mbi tjetrën për tu përshtatur sa më lehtë kushteve klimatike që mund të ndryshojnë gjatë ditës.

Gjatë mbledhjes dhe gjatë krasitjes prefero një veshje me mëngë të gjata dhe pantallona të gjata për të mbrojtur krahët e këmbët nga gërryerje te mundshme, acarime dhe nga pickimet e insekteve.

AGRI.BI.

Enti Bilateral për Agrikullturën Veroneze është krijuar në bazë të një marrëveshje të përbashkët midis Organizatave punëdhënëse dhe punëtorëve të sektorit bujqësor të provincës së Veronës: Confagricoltura Verona, Federazione Provinciale Coldiretti, Cia, Fai-Cisl, Flai Cgil e Uila-Uil.

AGRI.BI. ka për qëllim integrimin e trajtimit të përkujdesjes ligjore në rast sëmundje apo aksidenti të punëtorëve bujqësorë, furnizimin me forma të ndryshme në mbështetje të të ardhurave gjithmonë për punëtorët bujqësorë, promovimin e masave për të përmirësuar sigurinë në vëndet e punës në provincën e Veronës gjithashtu dhe promovimin e trajnimit për punëtorët dhe ndërmarrjet e sektorit bujqësor.